

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË
STUDIMET POSTDIPLOMIKE – MASTER

REZYME

Hyzer Bytyqi, me punimin **“INSTITUCIONI PËR PËRKUJDESJE NDAJ TË MOSHUARËVE (Shërbimi publiko-privat) - PRISHTINË”**, jep një aparcncë të një ndryshimi mbrenda strukturës familjare, theksuar faktin e ndryshimit të kujdesit ndaj njerëzve moshës së tretë. Duke ditur se shoqëria jonë, është duke e përjetuar cikël zhvendosjeje sa i përket mënyrës së jetesës atëher, kjo shkëputje dhe diferencim nga e vjetra në të renë, përbën një tematik tejet të rëndësishme sociologjike, e cila na orienton të themi se, kjo gjendje është një hyrje e një standardi të ri, i cili proklamon atë që quhet shoqëri e konsoliduar institucionalisht përkatësisht, tipike e definimit të shtetit modern. Autori i këij punimi bën përpjekje që t'i rëndis faktorët inicues dhe të analizoj formën ndryshimit rreth kujdesit ndaj të moshuarëve ndonëse, kujdesi për "pleqët" nuk është dëshmuar qartësisht se i takon mënyrës së kaluar të përkujdesjes e që nuk ekziston ende. Duke qenë se hulumtimi është realizuar në Prishtinë, atëher treguesit e gjendjes për kujdesin social ndaj të moshuarëve paraqitet mbrenda kësaj hapësire. Ndër pikat kryesore të këtij hulumtimi janë, trajtimi i faktorëve kulturor dhe social si furnizues në dinamikën e ndryshimit të formave të përkujdesjes ndaj të moshuarëve, si dhe analiza e të dhënave empirike, lidhur me perceptimi e të tashmes dhe vizionin e të ardhmes, për çështjen e gjeneratës së tretë në vendin tonë.

Për nga struktura, kandidati e ka ndarë punimin në tre pjesë apo kapituj.

Në pjesën e parë: Kandidati H. Bytyqi në strukturën e punimit përpos pjesës hyrëse dhe konceptit për përkujdesin social në Prishtinë, struktura e punimit përmban edhe tre kapituj, duke përfshirë këtu përfundimin dhe rekomandimet. Punimi është hulumtim empirik i mbështetur edhe me raporte, publikime, libra, e të dhëna nga institucionet e Republikës së Kosovës si dhe burime tjera nga website të ndryshme nga interneti me përmbajtje të punimit në fjalë. Punimi, ndërtohet

nga metoda sasiore dhe cilësore, poashtu është përdorur krahasimi si metodë në vete, të cilat japin gjetje të vlershme për gjendjen organike të së kaluarës rreth kujdesit social, gjendjen e tashme dhe hapat e pretenduar të së ardhmes. Gjithashtu edhe metoda analitike e ndjekur është qasja konstruktiviste, nisur nga fakti se konstruktivizmi e sheh botën në optikën e ideve, kulturave, normave dhe të perceptimit të strukturës sociale që kemi krijuar në një kontekst të caktuar e mbi të gjitha rreth qenies ontologjike ku në qendër është individi.

Kapitulli i parë: Përfshinë pjesën bazike mbi të cilin shtrohet gjithë idea për konceptin e hulumtimit të bërë, idenë, hyrjen qasje e ekzekutimit të problematikes së moshës tretë, strukturën e modelin e hulumtimit, strategjinë punuese, hipotezat e objektivat, rreth të cilave shtjellohet i gjithë punimi.

Në kapitullin e dytë: Trajton qasjen teorike mbi konceptin e përkujdesit ndaj të moshuarëve, duke ngre pyetjen në dilemen, familja apo shteti si kujdestar i të moshuarëve, meqenëse familja po përjeton tranzicionin në ndryshimin e vet strukturor, si rezultat i faktorëve kulturor-bindje, botëkuptim, mënyrë e stil ndryshe i jetës apo, ruajtje e vazhdueshme e një solidariteti, që familja shqiptare bartë në vete nga e kaluara e hershme me bazë normative tradicionale e pjesërisht religjioze në kujdesin ndaj gjeneratës së vjetër, në anën tjetër faktori social si rregulla të reja të sjelljes, shkallë e theksuar e individualizmit si formë jetes, ndikimi i arsimimit në dimensione të gjera shoqërore, zvogëlimi strukturor i familjes nga e kaluara dhe kufizimi i kohës i levizjes në hapësirë. Në qasjen teorike, i bëhet një përshkrim historik Institucionit Për Përkujdes Social në Prishtinë, gjendjes së tij pas përfundimit të luftës së fundit të 99-tës si dhe rimëkëmbjes e konsolidimit si institucion në vete. Me qëllim qartësimi sistemor të funksionimit të këtij institucioni, kemi trajtuar infrastrukturën ligjore për mirëqenie sociale, e poshtu hierarkinë institucionale mbrenda ministrisë përkatëse në kuadër të të cilës është institucioni për kujdes social. Pastaj, është bërë një skanim i mbrendshëm i këtij institucioni rreth mënyrës së funksionimit, kriteret e pranimit të rezidentëve, kushtet ambientale, shërbimet e përgjithshme-ushqimore, shëndetësore, veshmbathje e aktivitete tjera organizative.

Kapitulli i tretë : Pjesa e fundit e këtij projekti është përmbushja e kauzalitetit shkencor, në linjën empirike të nxjerrjes së të dhënave, në hulumtimin e opinionit nga intervistimi i qytetarëve rreth kujdesit social, duke u fokusuar në dy hapësira urbane të intervistimit qytetar, në qytetin e

Prishtinës dhe për të zgjeruar edhe më tej hulumtimin edhe në Lipjan, me një numër më të vogël respondentësh.

Përveç intervistimit qytetar, kapitulli i tretë ka në përmbajtje edhe pasqyren tabelare në numër të përgjithshëm të rezidentëve ose banorëve të moshuar në institucionin e kujdesit social në Prishtinë, poashtu tabelat treguese në numër të përkatësisë etnike dhe gjinore të tyre, si dhe realizimin e intervistave me disa banorë të përzgjedhur .Pjesa e fundit ka gjithashtu, edhe rekomandimet, sygjerimet e përfundimet e dalura nga gjithë projekti i realizuar.

Mentori :

Prof Dr. Fadil Maloku

Studenti :

Hyzer Bytyqi